

L I G J
Nr. 8954, datë 17.10.2002

**PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES SË GRANTIT NDËRMJET QEVERISË SË
REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE MBRETËRISË SË NORVEGJISË PËR ASISTENCË
NË FINANCIMIN E SHËRBIMEVE TË KONSULENCËS, PËR REHABILITIMIN DHE
PËRMIRËSIMIN E SISTEMEVE EKZISTUESE TË UJIT TË PIJSHËM DHE UJËRAVE TË
ZEZA NË BURREL, NË QARKUN E DIBRËS”**

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:**

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja e grantit ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Mbretërisë së Norvegjisë për asistencë në financimin e shërbimeve të konsulencës, për rehabilitimin dhe përmirësimin e sistemeve ekzistuese të ujit të pijshëm dhe ujërave të zeza në Burrel, në qarkun e Dibrës”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr. 3544, datë 7.11.2002 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

MARRËVESHJE

**GRANTI NDËRMJET QEVERISË SË MBRETËRISË TË NORVEGJISË DHE QEVERISË SË
REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË NË LIDHJE ME ASISTENCË NË FINANCIMIN E
SHËRBIMEVE TË KONSULENCËS, MATERIALEVE DHE PAJISJEVE NË LIDHJE ME
REHABILITIMIN DHE PËRMIRËSIMIN E SISTEMEVE EKZISTUESE TË UJIT TË PIJSHËM
DHE TË UJËRAVE TË ZEZA NË BURREL, NË QARKUN E DIBRËS NË REPUBLIKËN E
SHQIPËRISË**

Pasi Qeveria e Republikës së Shqipërisë (Shqipëria) nëpërmjet Ministrisë së Rregullimit të Territorit dhe Turizmit të Republikës së Shqipërisë (Ministria) në letrën e datës 27.11.2001 i ka kërkuar asistencë Qeverisë së Mbretërisë të Norvegjisë për rehabilitimin dhe përmirësimin e sistemeve ekzistuese të ujit të pijshëm dhe ujërave të zeza në Burrel, në qarkun e Dibrës të Republikës së Shqipërisë, dhe

Pasi Qeveria e Mbretërisë së Norvegjisë ka vendosur t’i përgjigjet kërkesës së bërë,

Atëherë, Qeveria e Mbretërisë së Norvegjisë dhe Qeveria e Republikës së Shqipërisë kanë arritur në kuptimin e mëposhtëm që do të përbëjë një Marrëveshje midis Palëve:

Neni 1

Objektivat

1. Kjo Marrëveshje përcakton kushtet dhe procedurat për asistencën e Qeverisë së Mbretërisë të Norvegjisë në rehabilitimin dhe përmirësimin e sistemit të furnizimit me ujë në qytetin e Burrelit,

siç përshkruhet në aneksin 1 të kësaj Marrëveshjeje (“Projekti”).

Projekti përshkruhet më tej në dokumentin e Projektit të datës shtator 2001.

2. Qëllimi i Projektit është zhvillimi ekonomik dhe social i zonave të Projektit, duke u fokusuar në furnizimin me ujë, kushtet e ujërave të zeza, si dhe në përmirësimin e kushteve shëndetësore.

Objektivat e Projektit janë rehabilitimi dhe përmirësimi i shërbimeve të furnizimit me ujë dhe të ujërave të zeza në një nivel të pranueshëm bashkëkohor sipas Strategjisë Kombëtare të Ujit të Republikës së Shqipërisë dhe rritjes së kapacitetit institucional të utiliteteve përgjegjëse për ujin.

Neni 2

Bashkëpunimi – Përfaqësimi – Administrimi

1. Qeveria e Mbretërisë së Norvegjisë dhe Qeveria e Republikës së Shqipërisë do të bashkëpunojnë plotësisht për të siguruar që qëllimet dhe objektivat e Projektit të realizohen me sukses. Për këtë efekt, secila Palë duhet t’i sigurojë Palës tjetër të gjithë informacionin e arsyeshëm të kërkuar në lidhje me Projektin.

2. Në çështjet që kanë të bëjnë me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, Agjencia Norvegjeze e Bashkëpunimit për Zhvillim (ANBZH) dhe Ministria duhet të jenë kompetente për të përfaqësuar Norvegjinë dhe Shqipërinë, respektivisht.

Ministria, nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Ujit, do të ketë të gjithë përgjegjësinë për zbatimin e Projektit.

Çdo shkëmbim informacioni me Norvegjinë në lidhje me këtë Marrëveshje duhet t’i drejtohet Ambasadës Mbretërore të Norvegjisë në Tiranë.

3. Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjetllës-Kanalizimeve duhet të lidhë kontratën e mëposhtme për zbatimin e Projektit.

- Kontratë (Kontrata e Konsulencës) me firmë konsulente norvegjeze (Konsulenti) në lidhje me: (i) koordinimin, rishikimin e Projektit, si dhe përgatitjen e kushteve të referimit dhe të dokumentacionit të tenderave për nënprojektit e veçanta; (ii) ofrojë konsulencë Drejtorisë së Përgjithshme të Ujit në përzgjedhjen dhe negociimin e kontratave me furnizuesit norvegjezë; dhe (iii) supervizimi i zbatimit të nënprojekteve nga Konsulenti (Shërbimet e Konsulencës).

Kontrata e Konsulencës dhe amendamentet e saj duhet të aprovohen nga Qeveria e Mbretërisë së Norvegjisë përpara se të hyjë në fuqi.

- Kontratë (a) me kontraktues lokal (Kontrata e Kontraktuesit) për kryerjen e punëve të rehabilitimit dhe përmirësimit të Projektit.

- Kontratë (a) (Kontrata e siguruesve) me sigurues lokal dhe norvegjez (Siguruesit) në lidhje me zbatimin e nënprojekteve.

- Drafti i Kushteve të Referimit dhe i dokumentacionit të tenderit të përmendura më lart duhet t’i jepen së pari Ministrisë dhe më pas Qeverisë së Mbretërisë të Norvegjisë për aprovim.

4. ANBZH-ja do të lidhë kontratë me një konsulent në lidhje me misionet teknike dhe financiare, referuar nenit 9 pika 2. Konsulenti, gjithashtu, do të ndihmojë Drejtorinë e Përgjithshme të Ujit në rolin e saj si punëdhënëse në procesin e ndërtimit, p.sh. të asistojë në procesin e tenderit për Kontratën e Konsulencës, duke iu përmbajtur kushteve të referimit e cila duhet t’i dorëzohet për informacion Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjetllës- Kanalizimeve. Kostoja e këtij konsulenti do të mbulohet nga ANBZH-ja, nëse është mbi apo nën subvencion.

5. Përfaqësues të Qeverisë së Mbretërisë të Norvegjisë dhe Shqipërisë duhet, nëse nuk vendoset ndryshe gjatë fazës së zbatimit të Projektit, të takohen të paktën dy herë në vit (takimi gjashtëmujor) me qëllim që:

- të shqyrtojnë ecurinë e Projektit;
- të diskutojnë rishikime të mundshme të planeve dhe buxheteve të Projektit;
- të diskutojnë propozime për zgjerimin e nënprojekteve aktuale ose të reja që do të përfshihen në Projekt;

- të aprovojë planet e punës dhe buxhetin;

- të diskutojnë çështje ose probleme të veçanta të zbatimit të Projektit.

Dokumentacioni i specifikuar në nenin 7 pika 1 dhe 2 do të jenë baza e takimit gjashtëmujor.

Takimi gjashtëmujor do të thirret dhe kryesohet nga Ministria.

Të dy Palët mund të përfshijnë të tjerë që do të prezantohen në delegacion si këshillues ose vëzhgues.

Elementët kryesorë të diskutimeve dhe të gjitha vendimet e marra nga takimi gjashtëmujor do të regjistrohen në protokoll. Protokollin do të formulohet nga Ministria dhe do t'i dërgohet Qeverisë së Mbretërisë të Norvegjisë për komente, jo më vonë se tre ditë pas takimit gjashtëmujor.

Kurdo që Qeveria e Mbretërisë të Norvegjisë dhe Qeveria e Republikës së Shqipërisë bien dakord për zgjatjen e nënprojekteve ose përfshirjen e nënprojekteve të reja, kjo duhet të regjistrohet; do të preferohej që regjistrimi të bëhej në protokollin e takimit gjashtëmujor.

Neni 3

Kontributet e Norvegjisë

Qeveria e Mbretërisë së Norvegjisë duhet t'i nënshtrohet urdhrave të Parlamentit dhe, në bazë të kushteve dhe procedurave të përcaktuara ose të cilave u referohet këtu, i mundëson Shqipërisë një ndihmë financiare që nuk duhet të kalojë 28 000 000 KNO (njëzet e tetë milion kroner norvegjez) "Granti", që do të përdoret ekskluzivisht për financimin e Projektit në periudhën e planifikuar 2002-2004.

1. Çdo interes i përfituar nga Granti mund të përdoret për të mirën e Projektit, si dhe bihet dakord mes Palëve në një dokument të shkruar.

2. Çdo fond që nuk përdoret plotësisht për një aktivitet mund, sipas marrëveshjeve të mëparshme mes Palëve, të përdoret për të mirën e aktiviteteve të tjera që përfshihen në Projekt.

3. Çdo fond i pashfrytëzuar dhe çdo rritje e pashfrytëzuar e interesit pas përfundimit të Projektit duhet t'i kthehet Qeverisë së Mbretërisë të Norvegjisë.

Neni 4

Kontributet dhe detyrimet e Shqipërisë

Qeveria e Republikës së Shqipërisë duhet të bëjë të gjitha përpjekjet e arsyeshme për të lehtësuar zbatimin me sukses të Projektit dhe duhet, si më poshtë:

1. Të ketë të gjithë përgjegjësinë për planifikimin, administrimin dhe zbatimin e Projektit, duke përfshirë të gjitha kategoritë e punëve, riparimeve dhe mirëmbajtjes së ndërtesave, pajisjeve, pjesëve të këmbimit, mallrave dhe materialeve që janë mundësuar në bazë të kësaj Marrëveshjeje.

2. Të sigurojë që Granti të reflektohet në planet dhe veprimet e Ministrisë dhe që llogaria e Projektit të mbahet në përputhje me metoda të pranueshme.

3. Të sigurojë objektet, shërbimet dhe marrëveshjet e përcaktuara në Kontratën e Konsulencës dhe Kontratën (at) e Siguruesve dhe të sigurojë dokumentacionin e nevojshëm për Shërbimet e Konsulencës, të cilave iu referua në Kontratën e Konsulencës.

4. Të sigurojë personel të mjaftueshëm të kualifikuar lokal, si dhe burime financiare, të cilat mund të nevojiten përveç ndihmës për zbatimin me sukses të Projektit.

5. Të sigurojë Konsulentit dhe Siguruesit (ve) dhe personelit të tyre akses në informacione dhe të dhëna, përfshirë vizita në zonën e Projektit, që mund të kërkojnë në mënyrë të arsyeshme për të siguruar përfundimin e suksesshëm të Projektit.

6. Të marrë masat e duhura për magazinimin e pajisjeve dhe të asistojë Siguruesin (it) në transportimin e pajisjeve në zonën e Projektit.

7. Të përjashtojë nga të gjitha taksat doganore, taksa, tatime dhe detyrime të tjera për të gjithë materialin dhe furnizimin e financuar nga Granti dhe të importuar në Shqipëri për të mirën e Projektit. Qeveria e Republikës së Shqipërisë merr përsipër pagesën e TVSH-së, duke e planifikuar në buxhetin e shtetit për Ministrinë.

8. Të paguajë ose të kërkojë heqjen e çdo lloji takse mbi të ardhurat ose takse tjetër personale qoftë në nivelin bashkiak, ose në nivelin e Republikës së Shqipërisë për personelin e huaj të Konsulentit (ve) dhe Siguruesit (ve) mbi pagesa që bëhen nga Qeveria e Mbretërisë së Norvegjisë, duke i planifikuar në Buxhetin e Shtetit për Ministrinë.

9. Të lëshojë të gjitha licencat e nevojshme të importimit, lejet e shkëmbimit me jashtë dhe leje ose viza që mund të kërkojnë për zbatimin e Projektit.

10. Të sigurojë sigurinë e personelit në zonat e Projektit edhe gjatë shërbimeve.

11. Të informojë menjëherë Norvegjinë për çdo rrethanë që pengon ose rrezikon të pengojë zbatimin me sukses të Projektit.

12. Të asistojë përfaqësuesit e Qeverisë së Mbretërisë të Norvegjisë në marrjen e lejeve për të vizituar çdo pjesë të zonës së Projektit për arsyen që lidhet me këtë Marrëveshje dhe të kontrollojë çdo të dhënë relevante, mallra dhe dokumente.

13. Në rast arresti ose burgimi, për çdo arsye të mundshme të çdo individ i joqytetar, i cili është siguruar nga kjo Marrëveshje, ose të fillimit të ndjekjes penale kundër tyre, të njoftojë Ambasadën Norvegjeze sipas procedurave të përcaktura internacionale dhe, pa vonesë, t'i japë të drejtën Ambasadës Norvegjeze për të vizituar individin (ët) e arrestuar ose të burgosur.

14. Të sigurojë akses në zonat e ndërtimit dhe, nëse është e nevojshme, të sigurojë fonde për të mbuluar humbjet dhe çdo kompensim që nevojitet.

Neni 5 Prokurimi

1. Qeveria e Republikës së Shqipërisë, nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjetllës-Kanalizimit ndërmerr të bëjë të gjithë prokurimin e mallrave dhe shërbimeve për Projektin dhe është përgjegjëse për kontratat që do të lidhen. Qeveria e Republikës së Shqipërisë duhet të tregojë etiketë shumë të lartë gjatë prokurimit dhe zbatimit të kontratës.

Kontratat me kontraktuesit lokalë dhe norvegjezë dhe me siguruesin lokal, referuar nenit 2 pika 3 që kalojnë shumën 100 00 KNO dhe çdo amendament i saj, duhet t'i dorëzohet Qeverisë së Mbretërisë së Norvegjisë për aprovim përpara se të hyjë në fuqi.

Shuma e këtyre kontratave me më pak se 100 00 KNO, që i janë dorëzuar ANBZH-së për aprovim, nuk duhet të kalojë 1 milion KNO.

2. Qeveria e Mbretërisë së Norvegjisë ose çdo përfaqësues i Qeverisë së Mbretërisë të Norvegjisë nuk do të ketë detyrime ligjore ose financiare të asnjë lloji për dëmtime ose humbje të shkaktuara nga Palët Kontraktuese ose nga Palë të treta, si rezultat i veprimeve ose mungesës së veprimeve gjatë performancës së secilës Palë në kontrata ose nga nënkontraktuesit e tyre të detyrave të përcaktuara në kontratën përkatëse ose çdo nënkontratë.

3. Prokurimi duhet të bëhet mbi parime të pranuar gjerësisht dhe me metoda të mira prokurimi dhe në përputhje me metodat e Bankës Botërore mbi tenderat, duke përfshirë formatin e dokumentit të ofertës për blerjen e mallrave dhe në përputhje me kufirin e përcaktuar më lart në pikën 1. Ftesat për tender ose në bërjen e ofertave, si dhe kontratat e prokurimit duhet, respektivisht, të përfshijnë një pikë që thotë që oferta për tender do të hidhet poshtë dhe kontrata do të anulohet në rast se për dhënien ose zbatimin e kontratës janë aplikuar metoda ilegale ose të korruptuara.

Asnjë ofertë, dhuratë pagesë apo benefit i çdo lloji, i cili mund të përbëjë një metodë ilegale ose të korruptuar, nuk duhet pranuar si në mënyrë direkte, ashtu dhe indirekte si nxitje ose lidhje dhe zbatim të kontratave të prokurimit. Çdo metodë e tillë do të jetë shkak për anulimin e kësaj Marrëveshjeje dhe/ose të kontratës përkatëse të prokurimit.

Të gjitha kontratat që do t'i dorëzohen Qeverisë së Mbretërisë të Norvegjisë duhet të shoqërohen nga një deklaratë nga Ministria, në të cilën deklarohet që u është përmbajtur rregulloreve të mësipërme të prokurimit.

4. Qeveria e Republikës së Shqipërisë, nëse i kërkohet, duhet t'i sigurojë Qeverisë së Mbretërisë të Norvegjisë të gjithë dokumentacionin mbi praktikën e saj të prokurimit, si dhe të veprimeve të bëra dhe të sigurojë akses në të gjithë dokumentacionet dhe të dhënat përkatëse. Qeveria e Mbretërisë së Norvegjisë mund të kërkojë akses në informacion gjatë çdo faze të prokurimit, edhe atëherë kur informacioni është vetëm për zyrtarët që bëjnë prokurimin. Ruajtja e këtij informacioni duhet të respektohet dhe informacioni duhet të bëhet publik pa patur pasoja negative mbi prokurimin.

5. Pajisjet dhe furnizimet që do të prokurohen nën këtë Marrëveshje dhe që do të përdoren nga Konsulenti (ët) për zbatimin e Shërbimeve të Konsulencës do të bëhen pronë e Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjetllës-Kanalizimit ose bashkisë pas përfundimit të Shërbimeve të Konsulencës.

6. Qeveria e Republikës së Shqipërisë duhet të sigurojë në legjislaturën e saj mjete të përshtatshme dhe efektive për të parandaluar dhe ndëshkuar metoda ilegale ose të korruptuara.

Neni 6

Pagesat

1. Pagesa për Shërbimin e Konsulencës do t'i bëhet Konsulentit direkt nga Qeveria e Mbretërisë së Norvegjisë, në përputhje me kushtet e Kontratës së Konsulencës, pas marrjes së faturave të siguruara nga Konsulenti dhe të vërtetuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjiellës-Kanalizimeve dhe Këshillit Norvegjes të Tregtisë (KNT), në përputhje me Marrëveshjen midis KNT-së dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme Norvegjeze të datës 29 qershor 2000.

2. Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjiellës-Kanalizimeve duhet të lidhë një kontratë (Kontrata Tripalëshe) me ANBZH-në dhe Konsulentin në lidhje me shërbimet e zhbursimeve, që kanë të bëjnë me pagimin e Kontraktuesit (ve) dhe të Siguruesit (ve).

3. Pagesa e Kontraktuesve lokalë dhe siguruesve norvegjezë dhe lokalë të kontraktuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjiellës-Kanalizimeve dhe Këshilli Norvegjez i Tregtisë do të bëhet direkt nga Qeveria e Mbretërisë së Norvegjisë nëpërmjet Konsulentit, në përputhje me kushtet e Kontratës Tripalëshe të lartpërmendur dhe pas marrjes së faturave të vërtetuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjiellës Kanalizimeve dhe Konsulentit.

4. Të gjitha faturat duhet të kenë numrin e Projektit të ANBZH-së (ALB 2005) dhe numrin e Marrëveshjes (ALB 01.002).

Neni 7

Raporte

1. Qeveria e Republikës së Shqipërisë do t'i dorëzojë Qeverisë së Mbretërisë të Norvegjisë brenda 30 ditëve përpara takimit gjashtëmuor një raport gjashtëmuor mbi zbatimin e Projektit. Format i për raportin gjashtëmuor është dhënë në aneksin II.

Raporti gjashtëmuor do të përmbajë:

- raporte mbi ecurinë, që japin informacion mbi rezultatet aktuale të krahasuara me rezultatet e planifikuara, plane pune dhe kufijtë kohorë, përdorimi i inputeve, problemet e hasura apo të parashikuara dhe informacione të tjera në lidhje me zbatimin.

- llogari të Projektit që kanë të bëjnë me buxhetin, duke specifikuar të ardhurat nga të gjitha burimet dhe shpenzimet.

2. Si pjesë e përgatitjes së takimit gjashtëmuor i përmendur më sipër në nenin 2 pika 4, Qeveria e Republikës së Shqipërisë brenda 30 ditëve përpara takimit gjashtëmuor do t'i dorëzojë Qeverisë së Mbretërisë të Norvegjisë:

- një plan pune të azhurnuar me rezultatet e planifikuara dhe kufijtë kohorë për secilin nënprojekt, përfshirë propozime për përfshirjen e nënprojekteve të reja në Projekt;

- buxhet të azhurnuar për Projektin, që tregon të gjitha shpenzimet për secilin nënprojekt.

Këto dokumente, së bashku me raportin gjashtëmuor do të sigurojnë themelet e diskutimit dhe të vendimeve që do të merren në takimin gjashtëmuor.

3. Qeveria e Republikës së Shqipërisë do t'i sigurojë Qeverisë së Mbretërisë të Norvegjisë një kopje të të gjitha raporteve që do të dorëzohen nga Konsulenti (ët) dhe Siguruesi (t) në përputhje me kushtet e përcaktuara në Kontratën e Konsulencës dhe Kontratën(at) e Siguruesit (ve), me aprovimin e Ministrisë dhe/ose komentet e saj. Raportet me aprovimin dhe/ose komentet do të dorëzohen brenda tre javëve pas marrjes së raporteve.

4. Qeveria e Republikës së Shqipërisë do t'i dorëzojë Qeverisë së Mbretërisë të Norvegjisë një raport përfundimtar brenda 6 muajve pas përfundimit të Projektit.

Raporti përfundimtar do të japë përmbledhje të rezultateve dhe aktiviteteve të ndërmarra, arritjet e krahasuara me qëllimet dhe objektivat dhe një vlerësim të efektivitetit të Projektit.

5. Qeveria e Mbretërisë së Norvegjisë, jo më vonë se 40 ditë përpara takimit gjashtëmuor, do t'i dorëzojë Shqipërisë raporte mbi pagesat e bëra nga Qeveria e Mbretërisë së Norvegjisë në përputhje me nenin 6, më lart.

6. Qeveria e Mbretërisë së Norvegjisë do të përgjigjet brenda 6 javëve pas marrjes së raporteve të lartpërmendura.

Neni 8 **Rezervimet**

1. Qeveria e Mbretërisë së Norvegjisë rezervon të drejtën të tërheqë disbursimet në çdo kohë në rast:

- kur Projekti zhvillohet në mënyrë të papërshtatshme në lidhje me qëllimet dhe objektivat;
- kur ndodhin ndryshime të konsiderueshme nga planet mbi të cilat është rënë dakord;
- kur burimet që do të sigurohen nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë nuk sigurohen siç është rënë dakord;
- kur dokumentacioni i specifikuar në nenin 7, më lart, nuk dorëzohet siç është rënë dakord;
- kur menaxhimi financiar i Projektit nuk është i kënaqshëm;
- kur kontratat të cilave iu referua në nenin 2 pika 3, më lart, prishen ose ndërpriten përpara se të plotësohen obligimet e përcaktuara në to.

2. Qeveria e Mbretërisë së Norvegjisë rezervon të drejtën të kërkojë pagimin e plotë ose të pjesshëm të fondeve nga Granti, nëse konstatohet që fondet ose pjesë të fondeve nuk janë përdorur në përputhje me kushtet e kësaj Marrëveshjeje, ose nuk jepet llogari në mënyrë të kënaqshme.

3. Qeveria e Mbretërisë së Norvegjisë do ta anulojë këtë Marrëveshje ose pjesë të kësaj Marrëveshjeje dhe ka të drejtën të kërkojë anulimin e çdo kontrate të financuar në kuadër të kësaj Marrëveshjeje, me efekt të menjëhershëm nëse ajo përcakton, në lidhje me çdo kontratë të financuar në kuadër të kësaj Marrëveshjeje, që përfaqësues të Shqipërisë kanë marrë pjesë në praktika të korruptuara dhe mashtruese ose të përfitimeve nga fondi i ndihmës gjatë prokurimit ose gjatë zbatimit të kontratës dhe Qeveria e Republikës së Shqipërisë nuk ka ndërmarrë veprimet e duhura, të kënaqshme për Norvegjinë për të rregulluar situatën.

4. Qeveria e Mbretërisë së Norvegjisë dhe Qeveria e Republikës së Shqipërisë bien dakord të bashkëpunojnë për të parandaluar korrupsionin në dhe gjatë Projektit. Qeveria e Mbretërisë së Norvegjisë dhe Qeveria e Republikës së Shqipërisë ndërmarrin të marrin masa të shpejta ligjore në vendet e tyre përkatëse për të ndaluar, investiguar dhe ndjekur ligjërisht në përputhje me ligjin e vendit çdo individ të dyshuar për korrupsion ose keqpërdorim tjetër të burimeve internacionale.

Neni 9 **Informacion – Vlerësim – Rishikim**

Rishikime të projekteve të përbashkëta të Qeverisë së Mbretërisë të Norvegjisë dhe Shqipërisë mund të kryhen me kërkesën e secilës Palë.

Nëse nuk vendoset ndryshe gjatë zbatimit të Projektit, do të bëhen rishikimet që ndjekin:

Do të bëhet rishikim në mes të Projektit, nëse kjo vlerësohet e nevojshme nga Palët në kohën e vendosur nga Palët. Kostoja e rishikimit do të mbulohet nga Granti.

1. Qeveria e Mbretërisë së Norvegjisë do të ketë të drejtën të kryejë çdo lloj misioni teknik ose financiar, të cilin ajo e konsideron të nevojshëm për vazhdimin e zbatimit të Projektit. Për të lehtësuar punën e individit ose individëve të udhëzuar për kryerjen e një misioni të tillë monitorues, Qeveria e Republikës së Shqipërisë do të sigurojë të gjithë asistencën, informacionin dhe dokumentacionin përkatës.

2. Qeveria e Mbretërisë së Norvegjisë ka të drejtën e monitorimit dhe të vlerësimit pas përfundimit të një nënprojekti, si dhe të drejtën t'i kërkojë Shqipërisë një raport përfundimtar të nënprojektit.

Neni 10 **Kundërshtimet – Hyrja në fuqi – Prishja e pikës**

1. Nëse hasen kundërshtime që kanë të bëjnë me zbatimin ose interpretimin e kësaj Marrëveshjeje, duhet të ketë konsultime midis autoriteteve kompetente të përcaktuara në nenin 2 pika 2 më sipër, me qëllimin e arritjes së Marrëveshjes. Në rastin e dështimit në arritjen e Marrëveshjes çështja duhet t'i kalohet Ministrisë së Punëve me Jashtë të Qeverisë së Mbretërisë të Norvegjisë dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shqipërisë.

2. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën e ratifikimit të saj nga Kuvendi Popullor i Republikës së Shqipërisë dhe do të qëndrojë në fuqi derisa të dy Palët të kenë plotësuar të gjitha detyrimet e përcaktuara në të. Nëse këto detyrime do të konsiderohen të plotësuara apo jo, kjo do të përcaktohet në konsultime midis Palëve.

3. Pavarësisht nga pika e mësipërme, të dyja Palët mund ta prishin marrëveshjen aktuale, duke i prezantuar Palës tjetër një njoftim të shkruar tremujor.

4. Në dëshmitë sa u tha më lart, i nënshkruari, duke vepruar në emër të qeverive të tyre përkatëse, nënshkruan këtë Marrëveshje në dy origjinale në gjuhën angleze.

SHTOJCË 1 PËRMBLEDHJA E PROJEKTIT

Emri i Projektit	Rehabilitimi i sistemeve të ujit të pijshëm dhe të ujërave të zeza në Burrel, Shqipëri.
Institucioni zbatues:	Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjetës-Kanalizimeve e Shqipërisë
Qëllimi i Projektit:	Qëllimi i Projektit është zhvillimi ekonomik dhe social i zonave të Projektit, duke u fokusuar në nevojat themelore të furnizimit me ujë, kushteve sanitare dhe përmirësimi të kushteve shëndetësore.
Objektivat e Projektit:	Objektivat e Projektit janë rehabilitimi dhe përmirësimi i shërbimeve të ujit dhe të ujërave të zeza në një nivel aktual të pranuar gjerësisht të bazuar në Strategjinë Kombëtare të Ujit në Republikën e Shqipërisë dhe rritje të kapacitetit institucional të utiliteteve përgjegjëse të ujit.
Rezultatet:	Pas përfundimit të rehabilitimit, investimet i transferohen Autoriteteve të Ujit në Burrel, në gjendje funksionimi. Rutina të bazuara në EDB për kthimin e kostos me anë të vjeljes së taksave nga përdoruesit të vendosur për operacione të ardhshme, si dhe mirëmbajtjen e shërbimeve në të ardhmen. Ndërtimi i institucioneve nëpërmjet operacioneve tregtare të ujësjetës.

Shqipëria: Kontribut në natyrë
Norvegjia: Deri 28.0 milion KNO
ZËRI – BURREL

(i) Rehabilitimi i sistemit të furnizimit me ujë	14.900.000
(ii) Rehabilitimi i sistemit të ujërave të zeza	5.600.000
(iii) Shërbime konsulente	6.000.000
(iiii) Shpenzime të paparashikuara	1.500.000
Totali	28.000.000